



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Enti Rregullator i Energjisë

TAKIMI NDËRMJET PËRFAQËSUESVE TË ERE, RREGULLATORIT TË KOSOVËS (ZRE) ME PALËT E INTERESIT, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS ALPEX SH.A., DHE TË OST SH.A., “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE SI DHE ANULIMIN E RREGULLAVE TË TREGTIMIT, TERMAT E PËRGJITHSHME, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 214, DATË 28.12.2017.

Në kuadër të miratimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të cilat do të shërbejnë operimit të Bursës së energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë, Enti Rregullator i Energjisë mirëpriti ditën e djeshme, datë 24 nëntor 2022, përfaqësues të Rregullatorit të Kosovës (ZRRE) të cilët zhvilluan një seancë publike të përbashkët me palët e interesit të të dy vendeve, ndër të cilët mund të përmëndim AAES, AK, FTL, KOSTT, KURUM, KESH, KESKO.

Në fjalën e tyre hyrëse Kryetarët e Enteve përkatës, theksuan rëndësinë e këtyre rregullave në vijim të bashkëpunimit dypalësh duke qënë një hap i rëndësishëm për krijimin dhe bashkimin e tregut të energjisë elektrike. Ky proces daton nga qershori i viti 2018 ku operatorët e sistemeve të transmetimit OST, KOSTT dhe ERE dhe ZRRE nënshkruan Memorandumin e mirëkuptimit për bashkimin e tregut të një dite në avancë dhe asaj të së njëjtës ditë, bashkëpunim ky që do të vazhdojë dhe pas miratimit të rregullave dhe nisjes së operimit të ALPEX.

Gjatë këtij takimi, Administratori i ALPEX, bëri një përshkrim të përgjithshëm të rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes, të propozuara nga ALPEX dhe OST sh.a.). Këto rregulla do të mundësojnë më tej operimin e Bursës.

Më pas u dëgjuan komentet e palëve të interesit të ftuar në këtë takim, i cili do të pasohet dhe nga dëgjesa dhe takime të tjera teknike deri në miratimin e rregullave të sipërpërmendura nga rregullatorët përkatës sërisht në një mbledhje të përbashkët mes rregullatorëve.

Këto rregulla palët e interesit mund ti gjejnë në faqjen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë për Shqipërinë, në linkun e mëposhtëm:

<https://ere.gov.al/sq/publikime/konsultime/rregullat-e-alpex>